


ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Agjencia Qendrore e Prokurimit*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **15 010 211**

Sa i përket tenderit për **Kontrate Kornize për shërbimet e pastrimit, ri-tender, Lot 1 dhe 10**



ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NPN "Uni-Project"

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Rexhep Krasniqi, pn

(Adresa)

Prishtine

(Vendi)

044 160 619

(Numri Telefonit)

10000

(Kodi postar)

+38138555592

(Numri i Faks-it)

Zt. Besnik Vrella

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@uniproject.org

(Adresa elektronike)

17 / 03 / 2017

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës].

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 24 Shkurt 2016 dhe plotësimet e dosjes së tenderit janë publikuar me 12 Maj 2016, kurse afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë 25 Maj 2016, ora 14:00.

Kriteri për vlerësimin e ofertave është: çmimi më i ulte

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikon shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Është organizuar procesi i hapjes publike të ofertave nga Autoriteti Kontraktues dhe në këtë drejtim nuk kemi vërejtje lidhur me procesin e hapjes

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Kompania 'Uni-Project', me datën 10 / 03 / 2017, ka parashtruar 'Kërkesën për Ri-shqyrtim' në Agjencinë Qendrore të Prokurimit duke prezantuar argumentet ligjore që si Operator Ekonomik pjesëmarrës, i kemi plotësuar të gjitha kërkesat dhe kushtet e parashtruara të Autoritetit Kontraktues për të na shpallur fitues i Lotit 1 dhe Lot 10 të tenderit për shërbimet e pastrimit, ri-tender.

Në 'Kërkesën për Rishqyrtim' kemi parashtruar argumente të mjaftueshme ligjore që Kompania 'Uni-Project' i përmbush të gjitha kërkesat dhe kushtet e Autoritetit Kontraktues për Lot 1 dhe Lot 10 prandaj nuk duhet të bëhet anulimi i tenderit për Lotet e lartpërmendura.

Autoriteti Kontraktues, me datën 13 / 03 / 2017, ka shqyrtuar Kërkesën për Ri-shqyrtim duke refuzuar shqyrtimin e tyre me arsyetim se pretendimet tona ankimore janë të njëjta me Ankesën e parashtruar në OSHP me datën 27 / 12 / 2016, dhe se nuk do të bëje shqyrtim të njëjta të argumenteve ligjore.

Duke u nisur nga fakti që pretendimet tona ankimore nuk janë shqyrtuar drejtpërdrejt, i drejtohem Organit Shqyrtues të Prokurimit nëpërmjet parashtrimit të Ankesës.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Kompania 'Uni-Project', pas analizimit dhe studimit të dokumenteve relevante të Autoritetit Kontraktues dhe pas Vendimit të saj për shpalljen e fitueseve për Lot 1 dhe Lot 10 për shërbimet e pastrimit, ri-tender konsideron se Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit, ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës.

Dispozitat e shkelura nga *Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit*, janë mese vijon:

1. Eshtë shkelur neni 59 i LPP-se (vlerësimi i ofertave);
2. Eshtë shkelur neni 17 i Rregullave të Prokurimit Publik (procesi i vlerësimit të ofertave);
3. Eshtë shkelur neni 65 – 72 të Ligjit të Prokurimit Publik; dhe
4. Eshtë shkelur neni 1, 6 dhe 7 i Ligjit të Prokurimit Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kompania 'Uni-Project', pas analizimit të teresishëm të dokumenteve relevante të Tenderit për **Shërbimet e Pastrimit, Ri-tender**, konstaton dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit, ka bërë shkelje esenciale dhe substanciale të dispozitave ligjore të kornizës ligjore për prokurim publike duke mohuar të drejtat ligjore të Kompanisë sone në fitimin e kontratës publike në mënyrë të rregullt dhe ligjore.

Pretendimet tona ankimore të drejtuara për shqyrtim tek Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit janë të njëjta si me pretendimet ankimore të drejtuara Autoritetit Kontraktues nëpërmjet Kërkesës për Ri-shqyrtim.

Pikat e Ankesës për shkeljet e pretenduara të Autoritetit Kontraktues janë të prezentuara si më vijon:

1. Autoriteti Kontraktues, me datën 8.03.2017, nëpërmjet e-mailit zyrtar njofton Kompaninë 'Uni-Project' me Eliminim nga konkurrenca nëpërmjet dorëzimit të Letrës së Tenderuesit të Pasuksesshëm dhe në të njëjtën datë publikon Njoftimin për Anulim në Portalin e KRPP-se për lot 1 dhe Lot 10 (**shih fakt nr. 1 – Letra për Tenderuesin e pasuksesshëm dhe Njoftimit për Anulim**);
2. Kompania 'Uni-Project', pas publikimit të Njoftimit për Dhenie të Kontratës, me datën 10 / 03 / 2017, pergadit dhe dorezon Kërkesën për Ri-shqyrtim tek Autoriteti Kontraktues duke shprehur mos-pajtimin për arsyet e eliminimit.

Kerkesa per Ri-shqyrtim, eshte pergaditur, nenshkruar dhe dorezuar zyrtarisht duke perdorur Formularin per Kerkese per Ri-shqyrtim duke e protokoluar zyrtarisht ne Agjencine Qendrore te Prokurimit (**shih fakt nr. 2 – Kerkesa per Rishqyrtim, e dates 10 / 03 / 2017**);

3. Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit, me daten 13 / 03 / 2017, refuzon Kerkesen per Ri-shqyrtim duke mos ofruar asnje fakt permbajtesor, te detajizuar dhe ligjor ne refuzimin e pretendimeve tona ankimore por vetem potencon se argumentet se argumentet ligjore te Kompanise ‘Uni-Project’ jane te njejta dhe jane shqyrtuar njehere si nga AQP-ja dhe OSHP-ja (**shih fakt nr.3 – Refuzimi i Kerkeses per Ri-shqyrtim, e dates 13 / 03 / 2017**);

Shenim:

Shih meposhte argumentet ligjore – pretendimet ankimore te dorëzuara nëpërmjet Kërkesës per Ri-shqyrtim qe ne pajtim me Rregullat e Reja te Parashtrimit te Ankesave, paraqiten edhe ne Ankesën drejtuar Organit Shqyrtues te Prokurimit per shqyrtim, shoshitje dhe argumentim me arsyetim ligjor para marrjes se Vendimit përfundimtar nga anëtarët e Panelit Shqyrtues te Organit Shqyrtues te Prokurimit Publik.

1. Autoriteti Kontraktues – Agjencia e Prokurimit Publik, pas Vendimit te OSHP-se, fillon me procesin e ri-vlerësimit te ofertave duke marre vendim per anulim te tenderit.

Ne arsyetimet e dhëna ne Raportin per Ri-vlerësimin e ofertave nga anëtarët e komisionit per vlerësimin e ofertave nuk jepen arsyeime ligjore përmbajtesore per eliminim nga konkurrenca te Kompanisë ‘UNI-PROJECT’ per Lot 1 dhe Lot 10.

2. Ne këtë drejtim, Kompania NPN UNI-PROJECT nuk pajtohet me vendimin e Komisionit per Ri-vleresim te Ofertave kur ku ky Komision ‘përsëri’ ne mënyrë krejtësisht arbitrare ka zgjedhur qe te mos marre parasysh te gjitha dëshmitë e dorëzuara nga kompania jone per kryerjen e shërbimeve te ngjashme gjate viteve 2013, 2014 dhe 2015.

Anëtarët e komisionit per vleresimin e ofertave kane shkelur ne kriteret e caktuara te vleresimit te ofertave (cmimi me i ulte) duke mos perzgjedhur Kompanine tone fituese te tenderit ne Lotet e caktuara me arsyetim se nuk kemi plotësuar kerkesat e potencuara ne FTD te dosjes se tenderit dhe njekohesisht duke demtuar financiarisht edhe Kompanine ‘Uni Project’ ne mos fitimin e kontrates publike.

Duke u nisur nga vleresimi subjektiv dhe jo-ligjor i zyrtareve te AQP-se, ne kundërshtim me nenin 59 te LPP-se (procesi i vleresimit te ofertave), Kompania ‘Uni Project’ eshte shpall e papergjegjsheme dhe jemi eliminuar nga procedura e metejme.

Eshte me rendesi te potencohet se Oferta e Kompanise ‘UNI-PROJECT’ ne tenderin e lartepemendur dhe ne Lotet e caktuara ka qene me e lire ne vlere prej **621 650.88 Euro** kundrejt O.E tjere pjesemarres.

Pra, përkundër faktit se kompania jone i ka plotësuar te gjitha kërkesat ekonomiko financiare, jemi eliminuar padrejtësisht nga Autoriteti Kontraktues duke na u mohuar kështu e drejta kushtetuese dhe ligjore per fitim te kontratave ne rruge ligjore (**shih fakt nr. 4 – Procesverbali i hapjes publike te ofertave**);

3. Anëtarët e komisionit per ri-vleresimin e ofertave ne konstatimet e tyre per oferten e Kompanise ‘UNI-PROJECT’ kane cekur se Deklarata Tatimore per 3 vjetet e fundit nuk eshte vlere prej 4.300.000 euro por ne vlere prej 3.506.157 euro.

Anëtarët e komisionit per vleresimi e ofertave kane pasur mundesine ligjore qe te verifikojne ne ATK por edhe ne Kompani per dokumentet deshmuese per gjendjen ekonomike dhe financiare per tri vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2105) per te konstatuar ligjshem se kemi deshmi te mjaftueshme kemi plotësuar ne menyre substanciale kete kerkese.

Prandaj, Kompania ‘UNI-PROJECT’ nuk e konsideron te ligjshme konstatimet e tyre ceshtjen e kontestuar pa vere verifikim paraprak dhe ligjor ne Administraten Tatimore te Kosoves dhe

4. Anëtarët e komisionit per ri-vleresimin e ofertave ne konstatimet e tyre per oferten e

Kompanise 'UNI-PROJECT' kane cekur se nuk kemi ofruar certifikatat perkatese ose ndonje dokument tjeter relevant qe deshmon performimin e tille te kontrates.

Keto konstatime te anetareve te komisionit per ri-vleresimin e ofertave jane te pabazuara per arsye se ne Oferte kemi dorezuar mjaftueshem certifikata dhe referenca per kontratat e realizuara dhe te performuara gjate tri viteve te fundit qe e tejkalon shumen e kerkuar ne vlere prej 2.025.000 euro.

Poashtu, poqese anetaret e komisionit per ri-vleresimin e ofertave kane pasur ndonje dyshim ose mungese te ndonje certifikate / reference per ndonje kontrate te realizuar kane mundur qe nepermjet nenit 72 te LPP-se te kerkojne scarime shtese dhe plotesim te dokumentacionit sa i perket certifikatave te kerkuara (**shih fakt nr. 5 – ekstrakti i raportit te ri-vleresimit te ofertave**).

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania 'Uni-Project', me plotesimin e te gjitha kerkesave/kushteve te tenderit ka interes te caktuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankeses dhe ka qene Ofertuesi potencial per fitimin e kontrates publike.

Vendimi i Agjencise Qendrore te Prokurimit por edhe te anetareve te komisionit per anulimin e tenderit 'pa ofrimin e argumenteve permbytësore ligjore' ka demtuar rende interesat materiale financiare te Kompanise sone per mos fitimin e nje Kontrate publike ne menyre te rregullte dhe te drejte, e qe garantohet me Ligjin e Prokurimit dhe Kushtetuten e Kosoves.

Prandaj, mos fitimi i nje kontrate publike ne menyre te rregullte ndikon ne shpenzime te ndryshme ligjore, largimin e punetoreve nga puna, humbja e fitimit nga projekti i realizuar, si dhe reputacioni i Kompanise sone ne tregun e Kosoves.

PROPOZIM

Duke u nisur nga prezantimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Kompania 'Uni-Project', kerkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shohitjen e fakteve ne menyre ligjore duke marre **Vendim per te kthyer lenden e kontestuar ne RI-VLERESIM te Ofertave** ne menyre qe te detyrohet Autoriteti Kontraktues – Agjencia Qendrore e Prokurimit, te beje Vleresim te drejte dhe objektiv te ofertave gjate procesit te serishem dhe te Ri te vleresimit te ofertave me anetar te rinj te komisionit per vleresimin e ofertave.

Kompania 'Uni-Project' kerkon nga anetaret e panelit shqyrtues te OSHP-se te mos bazohet ne 'arsyetimin' e pabazuar te AQP-se te mos i shqyrtoje argumentet tona te potencuara ne Ankese si 'ceshtje' e shqyrtuar si nga AQP-ja dhe OSHP-ja gjate vitit 2016 me rastin e parashtrimin te Ankeses ngase AQP-ja me rasti ne ri-vleresimit te ofertave pas vendimit te OSHP-se nuk ka bere 'verifikim' te kapacitetit teknik dhe financiar sipas nenit 65 – 72 te LPP-se ne asnje institucion publik per te verifikuar deshmitet e kerkuara teknike dhe financiare te prezentuara ne oferten e Kompanise sone.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.